

VENDIM
Nr. 927, datë 25.11.2020

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2020 NDËRMJET
INSTITUCIONEVE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në grupin buxhetor nr. 63 “Institucionet e sistemit të drejtësisë”, në programin “Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar”, shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, në zërin shpenzime personeli.

2. Në grupin buxhetor nr. 63 “Institucionet e sistemit të drejtësisë”, në programin “Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, pakësohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, në zërin shpenzime personeli.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe administrata e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama